Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**08.09.2023**	**22.09.2023**	**2023/0654**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.09.2023, OE "GETNO L.L.C."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0654, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Shkope drite" me nr. të prokurimit: "214-23-7650-1-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të kuotimit të çmimit, lloji i kontratës: furnizim.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0654 i dt:04.09.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 108-A i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Njoftimi për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt.24.07.2023, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt.01.08.2023 ku vetëm kompania jonë kemi qenë ofertuese. Me dt.21.08.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku është anuluar ky aktivitet i prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme, ndërsa neve jemi eliminuar me arsyetimin se**:**
Tek specifikacioni teknik është kërkuar Weight:0.14-0.17 lbs, ndërsa në katalog/broshurë është 20 gram. Pesha "Weight:0.14-0.17 lbs po të konvertohet në gram i bie që 0.14 lbs= 63.50293 gram.

Neve me dt.07.08.2023 na është kërkuar sqarime shtesë përmes formularit B47, si në vijim:
"Duke ju referuar njoftimit për kontrate dhe dosjes së tenderit neni 111.3 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale siç është kërkuar për kriterin e larte shënuar. Ju keni dorëzuar katalog/broshure nga prodhuesi për artikullin në finale mirëpo gjate vlerësimit kemi paqartësi ne lidhje me specifikacionet teknike pasi qe nuk janë te përfshira te gjitha specifikacionet teknike ne katalogun e dorëzuar nga ana e juaj. Andaj kërkojmë nga ana e juaj që të na dërgoni katalogun/broshurën e prodhuesit me përshkrime të specifikacioneve teknike të detajuar duke nënvizuar çdo pozicion në specifikacioneve teknike të kërkuara si ne

Aneksin 1 ne katalog/broshurën e prodhuesit. Duke përfshirë Secure lock hook top; Safe and easy to use Just bend and shake; Pack of 10or 25 —year life span; Weight:0.14-0.171bs; Warranty :min 2 Years si dhe çdo pozicion tjetër qe është i kërkuar ne specifikacionin teknike Aneksi 1 .
Andaj bazuar në nenin 59.2 dhe neni 72 kërkoj nga ana juaj që të na sqaroni dhe dëshmoni sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Ne i jemi përgjigjur kërkesës sw AK-sw për sqarime dhe i kemi dhënë sqarimet e nevojshme sipas kërkesës. Ne në ofertën tone e kemi bashkangjitur katalogun të cilin na ka dërguar prodhuesi për artikujt e kërkuar, ku në të njëjtin katalog mund të vërtetohet qartë se ne i kemi plotësuar specifikimet teknike. Përveç faktit që produktet tona janë konform specifikimeve teknike, të njëjtat produkte janë edhe më të mira se sa produkti që është kërkuar.

Ne me sqarime shtesë ju kemi bashkangjitur faktet dhe komunikimet me prodhuesin për të sqaruar kërkesën e AK-sw në lidhje me sqarimet e kërkuara.
Në sqarimet që i ka dhënë prodhuesi dhe katalogun të cilin ne e kemi prezantuar shihet qartë se specifikimet teknike të prezantuara nga ne janë të njëjtat me specifikimet teknike. Ndërsa sa i përket peshës së produktit të cilin e kemi prezantuar me 20 gram, ndërsa pesha e kërkuar nga AK-ja është 63.50 gram, ju sqarojmë se ky fakt nuk përbën ndonjë ndryshim të madh, përkundrazi pesha më e lehtë është edhe më mirë për policët.

Gjithashtu duhet cekur fakti se produkti me të cilin kemi ofertuar ne, me të njëjtat specifika është produkt i cili përdoret edhe nga NATO, ndërsa ky fakt tregon qartë se i njëjti produkt i plotëson kërkesat dhe specifikimet teknike.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura arsyetimi i eliminimit është i paqëndrueshëm sepse fakti i ndryshimit të peshës përbën devijim të vogël i cili nuk ndikon në substancë dhe në aspektin material, pra ky fakt mund të cilësohet devijim i vogël sipas nenit 59.4 pika (ii).
Pra ky fakt nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, sepse të gjitha karakteristikat tjera dhe specifikat janë në kuadër të kërkesave, madje janë edhe më të avancuara.

Duke pasur parasysh të gjitha sqarimet që u cekën më lartë, kuptohet qartë se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj është dashur të shpallemi të përgjegjshëm dhe të rekomandohemi për kontratë.

Bashkangjitur gjeni edhe një herë sqarimet tona të dhëna nga prodhuesi e ku vërtetohet edhe një herë se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Ne me dt. 28.08.2023 nga AK-ja kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim duke e cilësuar si të pa bazuar.
AK-ja në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në asnjë moment nuk ka dhënë ndonjë arsyetim në lidhje me pretendimet tona ankimore, mirëpo vetëm e ka përshkruar arsyen e njëjtë sikurse me rastin e eliminimit tek njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim AK-ja vetëm ka bërë përshkrimin e neneve të LPP-së kinse nuk ka bërë shkelje të asnjë dispozite të neneve për të cilat ne kemi pretenduar se

nuk janë respektuar, duke mos dhënë asnjë argument ose fakt të qëndrueshëm kundrejt pretendimeve tona.

Arsyetimi i AK-së për secilin nga pretendimet tona është pothuajse i njëjtë pasi që vetëm është theksuar se janë respektuar dispozitat ligjore dhe është shënuar teksti si në vijim: *Tek specifikacioni teknik është kërkuar Weight:0.14-0.17 lbs, ndërsa në katalog/broshurë është 20 gram. Pesha "Weight:0.14-0.17 lbs po të konvertohet në gram i bie që 0.14 lbs= 63.50293 gram.*
Ne në kërkesën për rishqyrtim kemi dëshmuar me fakte se arsyeja e AK-së është e pa qëndrueshme sepse produkti i ofruar nga ne është në përputhje me kërkesat FDT-së si dhe produkti jonë është produkt të cilin e përdor edhe NATO-së dhe i njëjti ka cilësi edhe më të mirë se sa produkti i cili është kërkuar në dosje të tenderit dhe tek specifikimet teknike.

AK-ja në mungesë te argumenteve për ta kundërshtuar këtë pretendim tonin ankimor vetëm ka bërë përshkrime të neneve të LPP-së dhe asgjë më shumë. Dihet qartë se autoriteti kontraktues është i obliguar të arsyetoj vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, ashtu siç është përcaktuar në nenin 108-A të LPP-së paragrafi *9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.*

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka marr parasysh fare nenin 59.4 të LPP-së, pasi që pesha e produktit të ofertuar përbën devijim të vogël i cili nuk ndikon në substancë dhe në aspektin material, pra ky fakt është dashur të cilësohet devijim i vogël sipas nenit 59.4 pika (ii*) "4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".*

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së dhe nenit 40 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se, **sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.**

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve dhe duke mos u shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "**Autoriteti kontraktues**

do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Gjithashtu në këtë tender nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
a) Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog broshure nga prodhuesi me një përshkrim të karakteristikave teknike të produkteve për secilin artikull, me te cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1).	**a) Katalogë broshure nga prodhuesi për secilin artikull me përshkrime të specifikacioneve teknike**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme MinistarstvoUnutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police
	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/ Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

DATA	29/08/2023
PER/ZA/TO	Operatori Ekonomik "GETNO L.L.C.", – Prishtinë
Cc	Fatmir Bajrami, Drejtor i Departamentit për Shërbime Mbështetëse
NGA	Artan Fejza, Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit
TEMA	Shqyrtimi i kërkesave për rishqyrtim nga Operatorëve Ekonomik "GETNO L.L.C.", – Prishtinë

Në mbështetje të nenit 108/A pika 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 60 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik për parashtrimin të kërkesave për rishqyrtim të miratuar nga KRPP-ja, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të datës 25/08/2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik " GETNO L.L.C.", – Prishtinë, si pale e interesuar për aktivitetin e prokurimit " Furnizim me Shkopë drite " me numër te prokurimit 214-23-7650-1-3-6, 214/23/114/136, të iniciuar nga Policia e Kosovës, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, nxjerr këtë:

VENDIM

MBI REFUZIMIN E KERKESËS PËR RISHQYRTIM TË PARASHTRUAR NGA "GETNO L.L.C.", – Prishtinë të datës 25/08/2023 , SI TË PABAZUAR

I. Refuzohet kërkesat për rishqyrtim nga OE "GETNO L.L.C.", – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit " Furnizim me Shkopë drite " me numër te prokurimit 214-23-7650-1-3-6, 214/23/114/136, iniciuar nga Policia e Kosovës.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendimi e anulimit nga AK – Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit " Furnizim me Shkopë drite " me numër te prokurimit 214-23-7650-1-3-6, 214/23/114/136, dhe Policia e Kosovës vazhdon me tutje.

ARSYETIM

OE " GETNO L.L.C.", – Prishtinë, si palë e pakënaqura ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK me datën 25.08.2023 kundër Njoftimi mbi vendimi e anulimit nga AK për tenderin " Furnizim me Shkopë drite " me numër te prokurimit 214-23-7650-1-3-6, 214/23/114/136, duke pretenduar se janë bere shkelje te dispozitave te LPP, Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, siç janë:

Pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik "GETNO L.L.C.", – Prishtinë

Neni 1:
Neni 6:
Neni 7:
Neni 59:
Neni 60:
Neni 69:
Neni 72
Neni 40 i rregullores NR 001/2022 për Prokurimit Publik

Përgjigjja në pretendimet ankimore të Operatori Ekonomik " GETNO L.L.C.", – Prishtinë

AK nuk ka bërë shkelje të neneve të lartë perënduara pasi gjatë vlerësimit të ofertave janë respektuar të gjitha dispozitat e LPP-se, në vijim japim sqarime të detajuara:

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 1 te LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se në mënyre me te drejt dhe efikase ka shfrytëzuar fondet publike, duke publikuar njoftimin për kontrate me procedure te hapur duke mos diskriminuar ose favorizuar asnjë OE, oferta e juaj është vlerësuar me kujdese dhe nga komisioni i vlerësimit oferta e juaj është e papërgjegjshme pasi qe nuk i keni plotësuar specifikacioneve teknike te detyrueshme te dosjes se tenderit Aneksi 1 ashtu siç është kërkuar. ofertuesi ka sjell broshure/ katalog mirëpo te specifikacioni teknike është kërkuar "Weight: 0.14-0.17lbs "ndërsa ne katalog/broshure është 20 gram. Pesha " Weight: 0.14-0.17lbs " po të konvertohet ne gram i bie qe 0.14lbs = 63.50293 gram.

Technical Data	
Dimensions	Length: 155 mm | Diameter: 17 mm | Weight: 20 g

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 6 te LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Ne këtë aktivitet te prokurimi Autoriteti kontraktues duke marre ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit fondet publike i ka përdorë ne mënyrën ekonomike pasi qe oferta e Juaj është papërgjegjshme sipas sqarimit te dhënë me larte pasi qe nuk i keni plotësuar specifikacionet teknike te kërkuara ne dosjen e tenderit Aneksi 1

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 7 te LPP-ës nuk qëndron pasi AK, sqaron se gjatë udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Oferta e juaj

është trajtuar pa diskriminim pasi qe oferta e juaj nuk i plotëson specifikacionet teknike te kërkuara ne dosjen e tenderit Aneksi 1 ashtu siç është kërkuar. Ju keni sjell broshure/ katalog mirëpo te specifikacioni teknike është kërkuar "Weight: 0.14-0.17lbs "ndërsa ne katalog/broshure është 20 gram. Pesha " Weight: 0.14-0.17lbs " po të konvertohet ne gram i bie qe 0.14lbs = 63.50293 gram.

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 59 te LPP-ës nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bere shkelje pasi që vlerësimi i ofertave është bere ne harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, konforme kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimin për kontrate dhe specifikacionet teknike te detyrueshme te Aneksi 1 i dosjes se tenderit, pasi qe ju si ofertues nuk i keni plotësuar specifikacionet teknike te detyrueshme Aneksi 1 ashtu siç është kërkuar. Specifikacioni teknik te detyrueshme nuk e keni plotësuar si ne vijim: te Aneksi 1 specifikacioni teknike është kërkuar "Weight: 0.14-0.17lbs "ndërsa ne katalog/broshure është 20 gram. Pesha " Weight: 0.14-0.17lbs " po të konvertohet ne gram i bie qe 0.14lbs = 63.50293 gram.

Technical Data	
Dimensions	Length: 155 mm | Diameter: 17 mm | Weight: 20 g

Pretendimet për shkelje te neni 60 të LPP-së, AK sqaron se nuk ka bërë shkeljen e këtyre neneve pasi që oferta e juaj është oferte e pa përgjegjshme pasi qe nuk keni plotësuar specifikacionet teknike te kërkuara ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit. Me këtë oferta e juaj është oferte e pa përgjegjshme qe nuk i plotëson kriteret e kërkuara.

Ne lidhje me pretendimin se AK ka bere shkeljen e nenit 69 të LPP, AK sqaron se nuk ka bërë shkelje pasi qe vlerësimi i ofertës është bere konforme kërkesave pasi qe sipas katalogut te ofruar nga ana e juaj pas kërkesës për sqarime specifikacioni i ofruar nuk është sipas kërkesave ne dosjen e tenderit Aneksi 1 i specifikacioneve teknike. Specifikacioni teknik te detyrueshme nuk e keni plotësuar si ne vijim: te Aneksi 1 specifikacioni teknike është kërkuar "Weight: 0.14-0.17lbs "ndërsa ne katalog/broshure është 20 gram. Pesha " Weight: 0.14-0.17lbs " po të konvertohet ne gram i bie qe 0.14lbs = 63.50293 gram.

Technical Data	
Dimensions	Length: 155 mm | Diameter: 17 mm | Weight: 20 g

Ju si Operator Ekonomik i interesuar dhe OE te tjerë ne fazën e publikimit nuk është bere ndonjë kërkesë për sqarime te dosjes se tenderit duke përfshirë edhe për specifikacionet e kërkuara nga ana e Autoritetit Kontraktues. Me këtë te gjithë OE janë pajtuar me specifikat teknike te dosjes se tenderit

Ne lidhje me pretendimin se AK ka bërë shkeljen e nenit 72 të LPP-së, AK sqaron se nuk ka bere shkelje pasi që AK ka kërkuar sqarime shtese sipas nenit 72 të LPP-së ku është sqaruar detajisht dokumentet në lidhje broshurën/katalogun me specifikacionin teknik. Edhe pas kërkesës për sqarime shtese burshura/katalogu i ofruar nuk i plotëson specifikacionet teknike te kërkuara sipas dosjes se tenderit Aneksi 1.

Ne lidhje me pretendimin se AK ka bërë shkeljen e nenit 40 i Rregullores nr 001/2022 për Prokurimit Publik, AK sqaron se nuk ka bere shkelje pasi që vlerësimi i ofertave është bere ne harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, ne hamroni me nenin 40 i Rregullores nr 001/2022 për Prokurimit Publik, konforme kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimin për kontrate si dhe specifikacionet teknike te detyrueshme te Aneksi 1 i dosjes se tenderit, pasi qe ju si ofertues nuk i keni plotësuar specifikacionet teknike te detyrueshme Aneksi 1 ashtu siç është kërkuar. Specifikacioni teknik te detyrueshme nuk e keni plotësuar si ne vijim: te Aneksi 1 specifikacioni teknike është kërkuar "Weight: 0.14-

0.17lbs "ndërsa ne katalog/broshure është 20 gram. Pesha " Weight: 0.14-0.17lbs " po të konvertohet ne gram i bie qe 0.14lbs = 63.50293 gram.

Technical Data	
Dimensions	Length: 155 mm | Diameter: 17 mm | Weight: 20 g |

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund te parashtroj ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij vendimi.

Vendimi i publikohet: Në platformën elektronike në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net

Vendimi i dërgohet:
- OE ankues
- Të gjithë OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet,
- Zyrës se Prokurimit,
- ZKA-së,

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **GETNO L.L.C.**

Pretendimi 1

OE ankues GETNO LLC pretendon se: "*Me dt.21.08.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku është anuluar ky aktivitet i prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme, ndërsa neve jemi eliminuar me arsyetimin se: Tek specifikacioni teknik është kërkuar Weight:0.14-0.17 lbs, ndërsa në katalog/broshurë është 20 gram. Pesha "Weight:0.14-0.17 lbs po të konvertohet në gram i bie që 0.14 lbs= 63.50293 gram.*

Neve me dt.07.08.2023 na është kërkuar sqarime shtesë përmes formularit B47, ku bazuar në nenin 59.2 dhe neni 72 është kërkuar nga ana jonë të sqarojmë dhe dëshmojmë sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate, duke dërguar katalogun/broshurën e prodhuesit me përshkrime të specifikacioneve teknike të detajuar duke nënvizuar çdo pozicion në specifikacioneve teknike të kërkuara si ne 4/4 Aneksin 1 ne katalog/broshurën e prodhuesit. Duke përfshirë Secure lock hook top; Safe and easy to use Just bend and shake; Pack of 10or 25 —year life span; Weight:0.14-0.171bs; Ëarranty :min 2 Years si dhe çdo pozicion tjetër qe është i kërkuar ne specifikacionin teknike Aneksi 1.

Ne i jemi përgjigjur kërkesës së AK-së për sqarime dhe i kemi dhënë sqarimet e nevojshme sipas kërkesës. Ne në ofertën tone e kemi bashkangjitur katalogun të cilin na ka dërguar prodhuesi për artikujt e kërkuar, ku në të njëjtin katalog mund të vërtetohet qartë se ne i kemi plotësuar specifikimet teknike. Përveç faktit që produktet tona janë konform specifikimeve teknike, të njëjtat produkte janë edhe më të mira se sa produkti që është kërkuar.

Në sqarimet që i ka dhënë prodhuesi dhe katalogun të cilin ne e kemi prezantuar shihet qartë se specifikimet teknike të prezantuara nga ne janë të njëjtat me specifikimet teknike. Ndërsa sa i përket peshës së produktit të cilin e kemi prezantuar me 20 gram, ndërsa pesha e kërkuar nga AK-ja është 63.50 gram, ju sqarojmë se ky fakt nuk përbën ndonjë ndryshim të madh, përkundrazi pesha më e lehtë është edhe më mirë për policët.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura arsyetimi i eliminimit është i paqëndrueshëm sepse fakti i ndryshimit të peshës përbën devijim të vogël i cili nuk ndikon në substancë dhe në aspektin material, pra ky fakt mund të cilësohet devijim i vogël sipas nenit 59.4 pika (ii). Duke pasur parasysh të gjitha sqarimet që u cekën më lartë, kuptohet qartë se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj është dashur të shpallemi të përgjegjshëm dhe të rekomandohemi për kontratë."

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues GETNO LLC, ka qenë ofertues i vetëm në këtë aktivitet prokurimi duke ofruar produktet e kërkuara sipas kërkesave nga ana e Autoritetit Kontraktues. OE ankues kishte dërguar katalogun/broshurën me specifikat e detajuara të produkteve të kërkuara nga AK përmes kërkesave për sqarim. Sipas katalogut/broshurës së dorëzuar eksperti sqaron se të gjitha specifikat e tjera të kërkuara në DT përveç peshës kanë qenë të përmbushura nga OE ankues sipas kërkesës. Sa i përket peshës së produkteve, OE përmes broshurës ka treguar se pesha e këtyre dritave është 20 gram përkatësisht këto drita kanë peshë më të lehtë se sa që është kërkuar nga AK, specifikisht që dritat të kenë peshë: *0.14-0.17 lbs apo* 63.50293 gram.

Duke u bazuar edhe në nenin 59, pika 4 (ii) thotë si më poshtë: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues është se një dallim i peshës së dritave të kërkuara në aktivitetin e prokurimit nuk përbënë devijim nga karakteri funksional i dritës siç mund të ishte madhësia e saj, kohëzgjatja e ndriqimit apo rezistenca ndaj ujit. Pesha e dritës konsiderojmë që nuk ndryshon asgjë sa i përket funksionit kryesor të përdorimit të dritës, përkundrazi vlerësojmë se pesha më e lehtë e dritës mund të ketë vetëm efekt pozitiv për përdoruesit. Andaj duke u bazuar në këtë çfarë u sqarua më lartë vlerësojmë se pretendimi i ngritur nga OE ankues është i bazuar dhe duhet të merret parasysh nga AK, se produkti i ofruar i përmbushë të gjitha kriteret dhe njëkohësisht mund të konsiderohet si produkt më i mirë se ai i kërkuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **GETNO L.L.C.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Agnese Ibrahimi

Ibrahimi